




Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



RAPORTI 6-MUJOR I PUNËS

JANAR-QERSHOR 2025

2025

RAPORTI 6-MUJOR I PUNËS

Perparim.Krasniqi@rks-gov.net

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2025

- Ka përfunduar vlerësimi i punëtoreve gjatë kësaj periudhe (deri më 31 janar 2025);
- Ka pasur aktivitete me kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, përvèç pastrimit të rrugëve nga bora, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat;
- Është bërë krasitja e drunjve dekorativë në qytet dhe në vendbanime të tjera;
- Ka filluar ndërtimi i pritoreve për pritjen e udhëtarëve në qytet dhe pikat që janë përcaktuar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, në përfundim të kësaj periudhe janë 16 pritore;
- Po vazhdon projekt i zgjerimit të kanalizimit sipas prioriteteve;
- Po vazhdon mirëmbajtja e rrugëve në zonën urbane, në përmirësimin e ujëmbledhësve dhe gropave të krijuara në rrugë;
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë disa ndërhyrje në rregullimin e shtyllave të ndriçimit publik, po ashtu ka pasur aktivitete në zgjerimin e ndriçimit publik;
- Kemi angazhuar stafin në bashkërendimin me drejtoritë e tjera në detyrat që janë dhënë në lirimin e hapësirave publike dhe inkasimin e mjeteve në shfrytëzimin e këtyre pronave;
- Është bërë marrëveshja e re me K.R.U. “Gjakova” për investime të përbashkëta publike;
- Po vazhdon projekt i gropave bioseptike sipas programit të EU-së, projekte nga IPA, janë në përfundim 6 gropë septicë;
- Po vazhdon projekt i rrugës 4-korsi, lot 1, në këtë periudhë ka përfunduar muri mbrojtës, janë në përfundim të dy lëshesave pllakore, si dhe gërmimi i rrugës në gjatësi 1.4 km;
- Në këtë periudhë është riasfaltuar rruga “Gzim Hamza-Piktori”;
- Është bërë barazimi i rregullt i të hyrave në drejtori;
- Ka filluar mirëmbajtja e hapësirave publike, eliminimi i deponive ilegale, pastrimi i hapësirave publike;
- Eshte nenshku memorandumi i financimit te projektit nga Ministria e Infrastrukturës per mbeshtetje financiare te projektit Rahovec-Drenoc Sarosh dhe Rahovec-Drenoc-Fortese, jemi ne fazën permbyllse te procedurave,
- Ka përfunduar ndërtimi i trotuareve në rrugën “Ibrahim Rugova” në Rahovec;
- Ka filluar rregullimi i një pjese të rrugës ndërmjet dy fshatrave Vrajakë dhe Bratatin si dhe rrëth rrotullimi;
- Po vazhdon projekt i ndërtimit të rrugës në Krushë të Madhe, “rruga e Drinit”,
- Ne kete periudhe kompanitë e kontraktuar, kanë filluar punimet në mirëmbajtjen e hapësirave publike, varreza, lapidare, rruge, trotuare, kemi punuar ne mirëmbajtje te ndriçimit publik, si dhe ne rregullim te pusetave dhe ujëmbledhësve si dhe ne largim te deponive ilegale,

RAPORTI 6-MUJOR I PUNËS

- Ka pasur dinamike te shtuar ne punimet e projektit rruga 4 korsi Lot 1, janë përfunduar dy lëshesat pllakore (urat), po vazhdon vendosja e gypave ne instalimet nëntokësore,
- Pritet gjate kësaj periudhe te rifillojnë punimet ne rrugën 4 korsi Lot 2,
- Ne lot 3, poashtu ka pasur punime ne rregullimin e pusetave dhe pergaditjen per largimin e shtyllave,
- Po vendosen shenjat ne vendndalimet për pritjen e udhëtareve (pritoret), ne fund te muajit qershor pritet te mbyllte si projekt,
- Po vazhdon projekt i ujerave te zeba ne shtrirjen e rrjetit te kanalizimit,
- Eshte duke vazhduar projekti i ndërtimit te rrugës tek pjesa e drinit nga kompania Hidroterm, janë duke përgatit shaktat, se bashku me elemente tjera nëntokësore,
- Vazhdojnë punimet ne segmentin rrugor, Sapniq-Nashpall-Vrajak, eshte bere hapja e trases, mbushja, ndërtimi i urës, po vazhdon ngjeshmëria,
- Eshte përfunduar traseja e rrugës dhe rrith-rrotullimit ne Vrajak dhe Bratatin,
- Po vazhdojne punimet ne fshatin Sapniq ne ndërtim te përroit,
- Ka filluar puna ne ndërtimin e rrugve ne qytet, projektet e para kemi fillu me trajtim te ujerave atmosferik te varret si dhe ne rrugën Halil Hamza,
- Është nënshkruar memorandumi për mbështetjen e projektit te rrugës Fortese -Sapniq me vlerë 650,000.00 euro,
- Kemi disa ndërhyrje ne përmirësimin e disa rrugëve, është trajtu problemi ne rrugën Ibrahim Rugova, po trajtohet problemi ne rrugën Mbreti Bardhyl është zgjidhur problemi mes palëve, ne krijimin e kushteve për trajtimin e ujerave atmosferik, ne rrugën Xhelal Hajda po ashtu janë krijuar disa zgjidhje per ujera atmosferik,
- Kemi filluar me projektin e ndërtimit te rrugëve lokale, ne fshatin Malësi e Vogël, rruga kah varrezat, e gjate 1200 metra.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2025:

- Sfidat kryesore e drejtorisë janë kërkesat e shumta për ndërtimin e rrugëve lokale, si dhe për rrugë dytësore dhe të pakategorizuara;
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellë gjatë këtyre viteve janë mbeturinat e amvisërisë dhe ato inerte që fatkeqësisht hidhen kudo, ku krijohen deponi ilegale, Komuna e Rahovecit çdo vit mirëmban hapësirat publike, por ato prapë hidhen kudo;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e K.R.U. "Gjakova".
- Rregullimi dhe furnizimi me energji elektrike, rigjenerimi i rrjetit të ri dhe kërkesa të shumta që adresohen nga qytetarët.

Drejtori i DShP-së

Përparim Krasniqi



Komuna e Rahovecit

Faqe 3